

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Nushe Kadrija, në çështjen penale kundër të akuzuarit V. A. nga fsh. P., K-Gjakovë, për shkak të veprës penale pengim i personit zyrtar gjate kryerjes se detyrës zyrtare nga neni 409/1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP.nr.802/2017 të dt.24.10.2017, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **28.08.2018**, në prani të Prokurorit së shtetit Ismet Tofaj dhe te akuzuarit ,të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari **V. A.** nga fsh.P., Komuna e Gjakovës, data e lindjes, i biri i R. dhe i T. e gjinisë Sh., ka të kryer shkollën e mesme, teknik medicinal ,i gjendjes se mesme ekonomike , shqiptar ,shtetas i R. Kosovës , i martuar atë i dy fëmijëve ,me ID .....

### Ë s h t ë f a j t o r

#### Sepse :

- **Me datë 31.05.2017, rreth orës11.22 min .**, në pikën kufitare në P. ,K-Gjakovë, me forcë apo kanosje pengon personin zyrtar në kryerjen e punëve zyrtare , në atë mënyrë që derisa zyrtarët policor P., D. V., Q. D. , M. H.dhe M. B., kanë qenë në pikën e kontrollit në udhëkryqin e rrugës P.- M. , i pandehuri shkon aty dhe e ndalon automjetin e tij , afër automjetit të zyrtarëve policor dhe pasi që zyrtarët policor kërkojnë nga i pandehuri që ta largoj automjetin e tij dhe ia kërkojnë të iu prezantoj dokumentet e automjetit dhe ato personale për legjitimim , i njëjti refuzon një gjë të tillë dhe shfaq sjellje arrogante duke i penguar personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare .

- **me çka ka kryer veprë penale pengim i personit zyrtar gjate kryerjes se detyrës zyrtare nga neni 409/1të KPRK-ës .**

Andaj Gjykata në mbështetje te nenit 4,41,43,50,51 , 73, 74 ,nenit 409/1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, te akuzuarit i shqipton :

### DËNIMI ME KUSHT

Dënim burgu në kohëzgjatje prej nga **3 (tre ) muajve**, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse të akuzuarit brenda kohës së verifikimin në afatin prej **1 (një) viti** , nuk kryejnë ndonjë veprë tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej **30,00 €**, shpenzimeve procedurale të paguaj shumen e përcaktuar nga gjykata si dhe në emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej **20,00 €** , në afat prej **15 ditëve** ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë .

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.802/2017 të dt.24.10.2017, ka akuzuar të akuzuarin V. A. nga fsh. P.c , K-Gjakovë , për shkak të veprës e penale pengim i personit zyrtar gjate kryerjes se detyrës zyrtare nga neni 409/1 të KPRK-së, duke propozuar që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe te dënohen sipas ligjit .

Gjykata konstaton se me dt. 20.02.2018, ka marr aktvendim mbi pezullimin e shqyrtimit gjyqësor ndaj të akuzuarit V. A. nga fshati P., Komuna e Gjakovës, për shkak të pamundësisë së sigurimit të prezencës së tij meqenëse nga Stacioni Policor në Gjakovë me njoftimin e datës 20.02.2018, me numër të Ref.04/1-08-GJ-S-69/18 ka njoftuar gjykatën se i njëjti gjendet në Zvicër dhe ndaj tij ka lëshuar urdhër arrest P.nr. 720/2017 të datës 20.02.2018.

I njëjti është paraqitur në Gjykatë me datën 28.08.2018, me ç ‘rast i njëjti do të procedohet dhe ndaj të njëjtit do të tërhiqet urdhër arrest

Prokurori i shtetit Ismet Tofaj , në shqyrtimin fillestar me dt.28.08.2018, l lexon aktakuzën PP.nr.802/2017 dt. 24.10.2017,me ç ‘rast prokurori deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari V. A. , gjatë shqyrtimit fillestar me dt.28.08.2018,duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë jam pënduar për veprimet e kryera në afekt meqenëse edhe personi zyrtar i cili më ka kërkuar dokumentacionin nuk ka qenë në nivel të veprimit sipas detyrës zyrtare meqenëse në momentin kur më janë kërkuar unë isha jashtë automjetit, mirëpo pavarësisht të gjithave kërkoj falje nga ata për veprimet e mia të pa qëllimshme që ti pengoj në kryerjen e detyrës zyrtare. Andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë ,premtimi se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme, do të jem me kujdes të mëtejshëm si dhe faktin se është hera e parë që kam ra në ndesh me ligjin të me shqiptojë një dënim me të butë

Prokurori i shtetit Ismet Tofaj , deklaron se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga të akuzuarit pasi që të njëjti janë të vetëdijshëm për pasojat dhe favorët juridike të pranimi të fajësisë e pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari V. A. : me datë 31.05.2017, rreth orës 11.22 min ., në pikën kufitare në P. ,K-Gjakovë, me forcë apo kanosje pengon personin zyrtar në kryerjen e punëve zyrtare , në atë mënyrë që derisa zyrtarët policor P., D. V., Q. D. , M. H.dhe M. B., kanë qenë në pikën e kontrollit në udhëkryqin e rrugës P.- M., i pandehuri shkon aty dhe e ndalon automjetin e tij , afër automjetit të zyrtarëve policor dhe pasi që zyrtarët policor kërkojnë nga i pandehuri që ta largoj automjetin e tij dhe ia kërkojnë të iu prezantoj dokumentet e automjetit dhe ato personale për legjitimim , i njëjti refuzon një gjë të tillë dhe shfaq sjellje arrogante duke i penguar personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare .

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarit të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajësinë , për shkak të se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-ës. Gjate pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë ,pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza , në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga të cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitive të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që i akuzuari të shpallet fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit , me pare duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e matjes së dënimit ,gjkata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese nuk gjeti përpos konstatimit të veprës së kryer, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e të akuzuarit se është baba i dy fëmijëve ,pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari , sjelljen korrekte të akuzuarit pendimin e shprehur ne gjykate për veprën e kryer ne afekt ,premtimin se ne te ardhmen nuk do te përsërisin vepra te tilla apo te ngjashme ,kërkimi falja para gjykatës nga të dëmtuarit për veprimet e tij si dhe faktin se i akuzuari më parë nuk kanë qenë të dënuar, të cilat rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 74 të KPRK-së, Gjykata të akuzuarit i shqipton dënim me burg ne kohëzgjatje prej 3(tre) muajve, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 41 dhe 50 të KPRK-së. Gjykata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në dispozitën e nenit 41 të KPRK-ës, se kjo do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryejnë vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale n të përcaktuara nga gjykata dhe në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 20,00 € ,është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së., dhe shpenzimet në shumë prej 30.00 € për kompensimin e Viktimave të Krimit numër 05/036.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.720/17 më datë 28.08.2018.**

**Sekretarja juridike,  
Nushe Kadrija**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës se Apelit ne Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.